



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**  
**KOMISIONERI PËR MBROJTJEN NGA DISKRIMINIMI**

Nr. \_\_\_\_\_ Prot.

Tiranë, më \_\_\_\_ / \_\_\_\_ /2018

**V E N D I M**

**Nr. 74, Datë 19 / 3 / 2018**

Bazuar në nenin 32/1/a dhe nenin 33 të Ligjit nr. 10221, datë 04.02.2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi mori në shqyrtim ankesën Nr. 142, datë 01.11.2017, të bërë nga E.Ç, kundër Drejtorisë Rajonale Arsimore Vlorë dhe shkollës “24 Maji” Vlorë në të cilën pretendohet për diskriminim për shkak të “gjendjes arsimore”.

Në përfundim të shqyrtimit të ankesës, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi,

**K O N S T A T O I:**

**I. Parashtrimi i fakteve sipas subjektit ankues.**

Sipas shpjegimeve të dhëna, subjekti ankues deklaroi se: “Që nga viti 2014 deri në periudhën Gusht 2017 ka qenë e punësuar me kontrata 2, 3 dhe 6 mujore, si mësuese e profilit të arsimit special. Në fillim të vitit shkollor 2017-2018 ka dorëzuar dosjen sipas njoftimit në DAR dhe është interesuar për pozicionin e punës në shkollën “24 Maji”. Në pritje të njoftimit është interesuar përsëri dhe ka marrë informacionin se mësuese ndihmëse ishte punësuar një mësuese jashtë profilit, me vetëm disa certifikata trajnimesh. Mësueset e punësuar nuk ishin të profilizuar për arsimin special sipas ligjit 69/2012 “Për arsimin parauniversitar” dhe Udhëzimit nr.38/2014 për arsimin e mësuesit ndihmës. Në DAR Vlorë i është sqaruar gojarisht se mësuesit e punësuar ishin sipas portalit ose sipas udhëzimit 38/2015 për lëvizjet paralele të mësuesve, ndërkohë që nuk ka një bazë ligjore që të përcaktoj se cili nga udhëzimet për lëvizjet paralele apo për kriteret e mësuesit ndihmës duhet ndjekur i pari, pasi specialistët e DAR pretendojnë se në fillim duhet përdorur udhëzimi për lëvizjen e mësuesve”. Në mes të tjerash E.Ç pretendon se: “Në muajin Maj dhe Shtator 2017 kanë marrë vendim emërimi mësues pa portal, jashtë profilit dhe me më pak vjetërsi në punë, si më poshtë: Shkollat 9-vjeçare: Selenicë (1 mësues ndihmës), “Muço Delo” (1 mësues) dhe “Lef Sallata” (2 mësues)”.

Subjekti ankues, kërkon nga Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi, konstatimin e diskriminimit.

## II. Ndjekja e procedurës për shqyrtimin e ankesës nga Komisioneri.

Në nenin 1 të ligjit nr. 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, parashikohet objekti i këtij ligji, duke u sanksionuar se: *“Ky ligj rregullon zbatimin dhe respektimin e parimit të barazisë në lidhje me gjininë, racën, ngjyrën, etninë, gjuhën, identitetin gjinor, orientimin seksual, bindjet politike, fetare ose filozofike, gjendjen ekonomike, arsimore ose shoqërore, shtatzaninë, përkatësinë prindërore, përgjegjësinë prindërore, moshën, gjendjen familjare ose martesore, gjendjen civile, vendbanimin, gjendjen shëndetësore, predispozicione gjenetike, aftësinë e kufizuar, përkatësinë në një grup të veçantë, ose me çdo shkak tjetër”*.

Diskriminimi për shkak të gjendjes arsimore është një nga shkaqet për të cilin ligji 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi” ofron mbrojtje dhe bazuar në nenin 32/1/c të ligjit, Komisioneri ka kompetencë për të shqyrtuar shkëljet që i bëhen zbatimit dhe respektimit të parimit të barazisë në lidhje me këtë shkak.

Bazuar në nenin 7 të ligjit nr. 10221/2010, mbrojtja nga diskriminimi garantohet ndaj çdo veprimi ose mosveprim të autoriteteve publike ose të personave fizikë a juridikë që marrin pjesë në jetën dhe sektorët publikë ose privatë, që krijojnë baza për mohimin e barazisë ndaj një personi apo grupi personash ose që i ekspozon ata ndaj një trajtimi të padrejtë dhe jo të barabartë, kur ata ndodhen në rrethana të njëjta ose të ngjashme, në krahasim me persona të tjerë ose grupe të tjera personash.

Bazuar në nenin 33/4 të ligjit Nr. 10221/2010, “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, ankesa e paraqitur nga subjekti ankues, znj.Çorroka, është e vlefshme nga pikëpamja formale pasi nuk ekziston asnjë nga rastet përjashtuese të parashikuara në këtë nen, që do ta bënte këtë ankesë të papranueshme. Si pasojë ankesa iu nënshtrua shqyrtimit të plotë.

Gjatë shqyrtimit të kësaj ankese, Komisioneri ka marrë në shqyrtim vetëm ato çështje, që bëjnë pjesë në kompetencat e tij, të parashikuara nga ligji nr. 10221, datë 04.02.2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”.

**Në zbatim të parashikimeve ligjore, të përcaktuara në nenet 32 dhe 33, të ligjit nr. 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, Komisioneri për mbrojtjen nga diskriminimi, ka shqyrtuar çështjen duke ndërmarrë hapat si më poshtë:**

- Me shkresën nr. 1068/1, datë 14.11.2017 është bërë njoftimi dhe i është kërkuar informacion subjektit, DAR Vlorë dhe Shkollës “24 Maji”, në lidhje me ankesën për pretendimin për diskriminim të paraqitur nga E.Ç.

Me shkresën nr. 2361, datë 30.11.2017 të dërguar pranë zyrës së Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi, Drejtoria Arsimore Rajonale Vlorë, në mes të tjerash ka informuar se: *“E.Ç ka qenë e punësuar në shkollën speciale PLM dhe në shkollën “24 Maji” me kontrata të ndryshme gjatë viteve 2014-2017. Mësueset, LB, MN dhe MS që janë punësuar si mësuese ndihmëse pranë*

shkollës “24 Maji” janë mësuese brenda profilit duke qenë se zotërojnë diplomë të nivelit të dytë në fushën e edukimit dhe certifikata trajnimi apo diplomë për fëmijët me aftësi të kufizuara. Sipas Udhëzimit 38/2015 dosjet e të gjithë aplikantëve dërgohen me postë dhe i dorëzohen Komisionit të Vlerësimit. Për vitin e kaluar në shkresën nr.2914, datë 30.11.2016 që disponon Komisioni i Vlerësimit dhe Sekretaria e DAR-it, E.Ç nuk ka dosje të dërguar për portalin “Mësues për Shqipërinë”. Mbështetur në udhëzimin e sipërcituar është bërë punësimi i mësueseve ndihmëse në shkollat “Lef Sallata dhe “Muço Delo”, ndërsa për rastin e shkollës “Todi Koceli” Selenicë është kërkuar ndërprerja e kontratës pa afat të mësueses ndihmëse dhe kalimi i saj me kontratë me afat”.

Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi në kuadër të shqyrtimit të ankesës nr.136, datë 24.10.2017 të shtetasës E.S kundër shkollës “24 Maji” Vlorë është vënë në dijeni të fakteve si më poshtë:

- Ankuesja E.Ç, me shkresën nr.157, datë 26.10.2016 “Kontratë individuale pune me kohëzgjatje të caktuar” të drejtorit të shkollës “24 Maji” Vlorë, është punësuar si mësuese ndihmëse me ngarkesë mësimore prej 12 orë në shkollën “24 Maji” dhe 12 orë në shkollën “Teli Ndini” për një periudhë deri më datë 09.06.2017.
- Me shkresën “Kërkesë” drejtuar DAR Vlorë datë 03.10.2017, E.Ç ka kërkuar për tu punësuar me vendim, pranë shkollës “24 Maji”. Me shkresën nr.1963, datë 06.10.2017, DAR Vlorë i ka bërë më dije se: “Punësimet në sistemin arsimor parauniversitar bëhen në bazë të ligjit 69/2012 i ndryshuar dhe Udhëzimit 38/2015, në të cilin parashikohet se konkurimi zhvillohet në tri faza: Konkurim me dosje, konkurim nëpërmjet testimit “Mësues për Shqipërinë” dhe zgjedhja e vendit të punës. Pra, dhe E.Ç duhet të bëhej pjesë e testimit “Mësues për Shqipërinë” dhe në bazë të renditjes do ofrohen dhe vendet e punës si dhe e ka informuar ankuesen, se rregjistrimet për portalin fillojnë në muajin Nëntor 2017”.
- Me shkresën nr.204, datë 03.10.2017, Drejtori i shkollës “24 Maji” ka informuar E.Ç se që prej vitit shkollor 2016-2017 në shkollë janë punësuar dy mësuese ndihmëse me kontratë të pacaktuar, LB dhe MN dhe në shkollë ka patur vetëm një vend vakant për mësuese ndihmëse, e cila është përzgjedhur mbi bazën e dosjes së dorëzuar pranë shkollës brenda afatit dhe E.Ç nuk ka dorëzuar dokumentacion për vitin e ri shkollor.
- Me shkresën datë 08.09.2017, Komisioni Multidisiplinar i DAR Vlorë ka përcaktuar se tri nxënës të shkollës “24 Maji” kanë nevojë për mësues ndihmës me ngarkesë të plotë, 24 orë në javë.
- Me shkresën datë 24.11.2017, Drejtorja e shkollës “24 Maji” ka njoftuar Komisionerin se në kuadër të zgjidhjes së ankesës së prindit të një prej fëmijëve që do asistoheshin me mësues ndihmës, drejtorja e shkollës në bashkëpunim me prindin ka marrë masat duke lidhur me datë 10.11.2017 kontratën e punës me kohë të caktuar me mësuesen E.Ç deri në datë 07.06.2018.

### III. Në përfundim të procedurave të shqyrtimit të ankesës dhe bazuar në dokumentacionin e administruar, Komisioneri vëren se:

#### A. Lidhur me pretendimin e ankueses se është trajtuar ndryshe nga shkolla “24 Maji”, përmes mos marrjes në punë.

Në Kreun 4, pika 9 të Udhëzimit nr. 38, datë 06.10.2015 të Ministrisë së Arsimit dhe Sportit “Për procedurat e lëvizjes paralele, emërimit dhe largimit nga puna të mësuesit në institucionet arsimore publike të sistemit arsimor parauniversitar” përcaktohet se: *“Për vendet e lira me ngarkesë mësimore të pjesshme apo të përkohshme, lidhet kontratë e përkohshme pune ndërmjet drejtuesit të institucionit arsimor dhe kandidatit....”*.

Në Kreun 7, pika 1 dhe 3 të Udhëzimit nr. 38, datë 06.10.2015 të Ministrisë së Arsimit dhe Sportit “Për procedurat e lëvizjes paralele, emërimit dhe largimit nga puna të mësuesit në institucionet arsimore publike të sistemit arsimor parauniversitar” përcaktohet se: *“Të gjithë mësuesit që mbeten pa ngarkesë mësimore, bëjnë kërkesë në njësinë arsimore vendore për lëvizjen paralele të detyrueshme....”*, ndërsa në pikën 3 përcaktohet se: *“..... Renditja fillon me mësuesit me më shumë pikë që janë për lëvizje paralele të detyrueshme, vijon në rend zbritës.....”*.

Referuar legjislacionit të sipërcituar konkludohet se, mësuesit që mbeten pa ngarkesë mësimore në përfundim të vitit shkollor kanë përparësi në punësimin e tyre si mësues duke ndjekur procedurat e punësimit për lëvizje paralele të detyrueshme, sipas profilit të kualifikimit. Përsa më lart dhe mësueset LB dhe MN, janë emëruar nga DAR Vlorë, si mësuese ndihmëse në shkollën “24 Maji” që në vitin shkollor 2016-2017<sup>1</sup>, pasi u është suprimuar pozicioni i punës në shkollat respektive ku ato ushtronin profesionin e mësuesit.

Në lidhje me punësimin e mësueses MS, vlerësohet se, me shkresën nr.1916, datë 29.09.2017, DAR Vlorë ka njoftuar shkollën “24 Maji” për miratimin e një mësuesi ndihmës si dhe e ka informuar se për shkak se në listën e kandidatëve të shpallur fitues në portalin “Mësues për Shqipërinë” në Arsimin Special nuk ka aplikantë fitues në pritje, shkolla të bëjë shpallje për punësim të përkohshëm<sup>2</sup>.

Shkolla “24 Maji”, në datë 28.09.2017 ka shqyrtuar dosjet e kandidatëve që kanë aplikuar<sup>3</sup> për postin e mësuesit ndihmës dhe në bashkëpunim me prindërit e nxënësës ka zgjedhur si mësuese ndihmëse MS.

<sup>1</sup> L.B emëruar si mësuese ndihmëse për nxënësen Sh.S dhe M.N si mësuese ndihmëse për nxënësen E.Xh.

<sup>2</sup> Referuar provave të disponuara gjatë inspektimit datë 26.10.2017 në kuadër të shqyrtimit të ankesës nr.136, datë 24.10.2017 të shtetases ES.

<sup>3</sup> Referuar shkresës datë 11.10.2017 të drejtorit të shkollës “24 Maji”, E.Ç në datë 11.10.2017 ka lënë poshtë derës së drejtorisë dosjen e saj personale.

Drejtoria e shkollës “24 Maji” me shkresën nr.203, datë 25.09.2017 “Kontratë individuale pune me kohëzgjatje të caktuar” ka lidhur kontratë pune me MS si mësuese ndihmëse në arsimin fillor për periudhën deri në daljen e rezultateve të portalit “Mësues për Shqipërinë” të vitit 2017-2018.

### **Lidhur me kualifikimin e mësueseve L.B, M.N dhe M.S, vlerësohet se:**

Në Nenin 1/a/b të Udhëzimit nr.38, datë 07.10.2014 “Për kriteret e mësuesit ndihmës për nxënësit me aftësi të kufizuara në institucionet publike të arsimit parauniversitar” përcaktohet se: “Mësuesi ndihmës për nxënësit me aftësi të kufizuara në institucionet arsimore publike duhet të plotësojë këto kritere: a) Të jetë pajisur me diplomë të ciklit të dytë në fushën e edukimit, konform kërkesave të nenit 57, pika 2<sup>4</sup>, të ligjit nr.69/2012 “Për sistemin arsimor parauniversitar në Republikën e Shqipërisë” dhe b) “Të ketë kryer trajnime të specializuara për trajtimin dhe arsimimin e nxënësve me aftësi të kufizuara dhe të jetë i pajisur me certifikatë/dëshmi/diplomë që vërteton këtë kompetencë profesionale të shtuar”.

Nga verifikimi i kualifikimeve të mësueses MS, faktehet se është e pajisur me Diplomë Bachelor në Pedagogji të Specializuar të lëshuar nga Universiteti “Ismail Qemali” Vlorë si dhe ka përfunduar studimet në ciklin e dytë në programin Master i Shkencave në “Pedagogji e specializuar” në Universitetin “Ismail Qemali” Vlorë.

Nga verifikimi i kualifikimeve të mësueses LB, faktehet se është e pajisur me Diplomë në degën “Cikël i Ulët” të lëshuar nga Universiteti Teknologjik “Ismail Qemali” Vlorë si dhe është e pajisur me Certifikatë për pjesëmarrje të suksesshme në trajnimin “Zbatimi i standarteve për fëmijët në Institucionet Rezidenciale”.

Nga verifikimi i kualifikimeve të mësueses MN, faktehet se është e pajisur me Diplomë në degën “Parashkollor” të lëshuar nga Universiteti Teknologjik “Ismail Qemali” Vlorë si dhe zotëron Diplomë të Integruar të Nivelit të Dytë si mësuese e lëndës së Gjuhës dhe Lëtërsisë.

Nga verifikimi i kualifikimeve të mësueses EÇ, faktehet se është e pajisur me Diplomë Bachelor në Pedagogji të Specializuar të lëshuar nga Universiteti “Ismail Qemali” Vlorë si dhe ka përfunduar studimet në ciklin e dytë në programin Master i Shkencave në “Pedagogji e Specializuar Sociale” në Universitetin “Ismail Qemali” Vlorë.

Referuar legjislacionit të sipërcituar dhe procedurave të kërkuara arrihet në përfundimin se punësimi i mësueseve të sipërpërmendura në pozicionet si mësuese ndihmëse në shkollën “24 Maji”, është kryer sipas procedurave të kërkuara nga legjislacioni në fuqi, pasi mësueset L.B dhe M.N janë punësuar me lëvizje paralele të detyrueshme dhe mësuesja M.S është punësuar si mësuese me kontratë me kohëzgjatje të caktuar nga drejtuesi i institucionit arsimor.

---

<sup>4</sup> “Mësuesi ..... që punon me nxënësit me aftësi të kufizuara, duhet të ketë fituar diplomë të ciklit të dytë në fushën e edukimit”.



**Lidhur me pretendimin për punësimin e mësueseve jashtë profilit në shkollat 9-vjeçare: “Todi Koceli” Selenicë, “Muço Delo” dhe “Lef Sallata” Vlorë, vlerësohet se:**

Në Kreun 4 “Procedura e zgjedhjes së vendit të punës dhe emërimi i mësuesit”, pika 1 të Udhëzimit nr. 38, datë 06.10.2015 të Ministrisë së Arsimit dhe Sportit “Për procedurat e lëvizjes paralele, emërimit dhe largimit nga puna të mësuesit në institucionet arsimore publike të sistemit arsimor parauniversitar” përcaktohet se: *“Kandidati, i cili në renditjen e përgjithshme sipas profilit/lëndës është renditur me numrin më të madh të pikëve, ka të drejtën e zgjedhjes për vendet e lirata punës në institucionet arsimore”*.

Ankuesja, referuar dokumentacionit të dërguar pranë Komisionerit nuk ka vërtetuar se ka konkuruar në portalin “Mësues për Shqipërinë” në mënyrë që të përfitonte për tu zgjedhur në vendet e lira të punës për mësues ndihmës, ndërkohë që DAR Vlorë me shkresën nr.1963, datë 06.10.2017 “Kthim përgjigje” ka informuar E.Ç që për të përfituar nga vendet e lira të punës duhet të bëhet pjesë e testimit “Mësues për Shqipërinë”.

Referuar dokumentacionit të dorëzuar nga palët vlerësohet që mësueset, EK dhe EN të emëruara si mësuese ndihmëse në shkollat “Muço Delo” dhe “Lef Sallata” Vlorë, kanë qenë pjesë e testimit sipas portalit “Mësues për Shqipërinë” në profilin “Arsimi Special” dhe plotësonin kriteret për tu emëruar sipas procedurave të Udhëzimit nr. 38, datë 06.10.2015 të Ministrisë së Arsimit dhe Sportit ndërkohë që emërimi i mësueses ndihmëse EI në shkollën “Todi Koceli” Selenicë nuk është bërë sipas procedurave të përcaktuara në udhëzimin e sipërcituar dhe për këtë arsye DAR Vlorë i ka kërkuar drejtores të shkollës “Todi Koceli” Selenicë ndërprerjen e kontratës pa afat të mësueses E.I. Drejtoresha e shkollës “Todi Koceli” Selenicë me shkresën datë 30.11.2017 ka njoftuar mësuesen E.I për zgjidhjen e kontratës së punës pa afat, për arsye se është bërë në shkelje të Udhëzimit nr. 38, datë 06.10.2015.

Për sa më lart dhe referuar Udhëzimit nr. 38, datë 06.10.2015 të Ministrisë së Arsimit dhe Sportit “Për procedurat e lëvizjes paralele, emërimit dhe largimit nga puna të mësuesit në institucionet arsimore publike të sistemit arsimor parauniversitar”, vlerësohet se procedurat e emërimit të mësueseve, EK dhe EN janë bërë sipas renditjes së portalit “Mësues për Shqipërinë” dhe si rrjedhim nuk mund të ketë veprime direkte të trajtimit të pabarabartë të subjektit ankues, ndërkohë që janë marrë masat nga ana e DAR Vlorë për ndërprerjen e kontratës pa afat për mësuesen E.I.

Diskriminimi përkufizohet nga ligji 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi” në nenin 3, pika 1, si: *“Çdo dallim, përjashtim, kufizim apo preferencë, bazuar në cilindo shkak të përmendur në nenin 1 të këtij ligji, që ka si qëllim apo pasojë pengesën apo bërjen e pamundur të ushtrimit në të njëjtën mënyrë me të tjerët, të të drejtave e lirive themelore të njohura me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë, me aktet ndërkombëtare të ratifikuara nga Republika e Shqipërisë, si dhe me ligjet në fuqi.*

Në nenin 12/1/b) të Ligjit nr. 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, parashikohet se: *“Ndalohet diskriminimi i personit në lidhje me të drejtën e tij për punësim. Diskriminimi përfshin çdo dallim, kufizim ose përjashtim që bazohet në shkaqet e përmendura në nenin 1 të këtij ligji dhe që, ndër të tjera, ka lidhje me: rekrutimin dhe përzgjedhjen e punëmarrësve”*.

Ligji për mbrojtjen nga diskriminimi ndalon situatat kur persona ose grupe personash në një situatë të njëjtë trajtohen në mënyra të ndryshme, dhe situatat kur personat ose grupet e personave në situata të ndryshme trajtohen njësoj.

Gjithashtu, diskriminimi karakterizohet nga trajtimi i diferencuar, pra duhet të demonstron se viktima e pretenduar është trajtuar në mënyrë më pak të favorshme për shkak të një karakteristike që përfshihet në “shkakun e mbrojtur”. Trajtimi më pak i favorshëm përcaktohet me anë të krahasimit ndërmjet viktimës së pretenduar dhe një personi tjetër në një situatë të ngjashme, i cili nuk posedon karakteristikën e mbrojtur.

Për të vërtetuar se ndaj ankueses ka një sjellje diskriminuese nga ana e shkollës “24 Maji” dhe DAR Vlorë, duhet të ekzistojë një lidhje shkakësore ndërmjet shkakut të mbrojtur nga ligji 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”<sup>5</sup> dhe trajtimin të pafavorshëm të ankueses.

Nga dokumentet e administruara gjatë trajtimit të ankesës, dhe shpjegimet e dhëna nga palët, lidhur me marrëdhëniet e punësimit mes subjektit ankues dhe shkollës “24 Maji” dhe DAR Vlorë, vlerësohet se E.Ç ka patur marrëdhënie punësimi me kontrata me afat me shkollën “24 Maji” dhe DAR Vlorë që prej vitit 2014 e në vijim si mësuese ndihmëse. Pra vlerësohet se nuk ka patur veprime, paragjykitime apo trajtim të pabarabartë për shkak të gjendjes arsimore të E.Ç.

Për sa më lart, Komisioneri vlerëson se nuk konstatohet trajtim i pabarabartë i ankueses në raport me mësueset: M.S, L.B, M.N, E.K dhe E.N, pasi veprimet e shkollës “24 Maji” dhe DAR Vlorë, nuk kanë qenë diskriminuese në drejtim të trajtimit të kërkesës së E.Ç.

Ndërsa sa i takon pretendimit të ankueses mbi punësimin si mësues ndihmës të punonjësve pa profilin e duhur në shkollat e DAR Vlorë, Komisioneri vlerëson se për këto pretendime bazuar në Kreun III, neni 2<sup>6</sup> të Udhëzimit Nr. 38, datë 07.10.2014 “Për kriteret e mësuesit ndihmës për nxënësit me aftësi të kufizuara në institucionet publike të arsimit parauniversitar”, duhet ti drejtoheni me shkrim Inspektoriatit Shtetëror të Arsimit si institucioni përgjegjës për zbatimin e kriterëve dhe procedurave të emërimit të mësuesit ndihmës. **Në përfundim, për sa më sipër, Komisioneri vlerëson se veprimet e DAR Vlorë dhe shkollës “24 Maji” Vlorë në drejtim të punësimit të E.Ç nuk kanë qenë diskriminuese, pasi përmbushja e kriterëve ligjore për**

<sup>5</sup> Në interpretim të nenin 1, të ligjit “Për mbrojtjen nga diskriminimi”, “...ky ligj rregullon zbatimin dhe respektimin e parimit të barazisë në lidhje me gjininë, racën, ngjyrën, etninë, gjuhën, identitetin gjinor, orientimin seksual, bindjet politike, fetare ose filozofike, gjendjen ekonomike, arsimore ose shoqërore, shtatzaninë, përkatësinë prindërore, përgjegjësinë prindërore, moshën, gjendjen familjare ose martesore, gjendjen civile, vendbanimin, gjendjen shëndetësore, predispozicione gjenetike, aftësinë e kufizuar, përkatësinë në një grup të veçantë, ose me çdo shkak tjetër”.

<sup>6</sup> “Zbatimi i kriterëve dhe procedurave të emërimit dhe largimit nga puna të mësuesit ndihmës, sipas përcaktimeve të këtij Udhëzimi, janë objekt i inspektimit të Inspektoriatit Shtetëror të Arsimit”.

emërimin e mësuesve ndihmës nuk përbën trajtim më pak të favorshëm, krahasuar me personat e tjerë që i përmbushin këto kritere.

### **PËR KËTO ARSYE :**

Mbështetur në nenet 1, 3/1, neni 7/1, neni 12/1/a), b), nenin 32, pika 1/a), c), si dhe nenin 33, pika 10 të Ligjit Nr.10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi,

### **V E N D O S I :**

1. Konstatimin e mosdiskriminimit të shtetases E.Ç, për shkak të gjendjes arsimore, nga ana e Drejtorisë Arsimore Rajonale Vlorë dhe shkollës “24 Maji” Vlorë.
2. Kundër këtij vendimi lejohet ankim në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, brenda afateve ligjore.

**Irma BARAKU**

---

**KOMISIONERI**

(shkaku: gjendja arsimore)

(fusha: punesim)